



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/N14 – 9 Prot.

Tiranë 10/07/2025

Nr. Dok. 202500084/9

Lënda: Kërkesë për plotësimin e detyrimit ligjor për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit si dhe për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a për mungesë bashkëpunimi.

SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME SARANDË SH.A
Rruga Skënderbeu, Lagjia Qafë Gjashtë, Sarandë

SARANDË

Për dijeni: Znj. N. T.
Pranë zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit
Rruga "Abedin Dino" Kati I i Godinës së Bashkisë Sarandë,

SARANDË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në administrim ankesë/kërkesë, në gusht të vitit 2022, të shtetas znj. N. T. e cila ka shprehur pretendimin dhe shqetësimin e disiplinimit të ujërave të bardha dhe të ndotura në bllokun e banesave në lagjen nr.1 Sarandë, ku banesa e saj ndodhet në hyrje të qytetit të Sarandës. Ankuesja shprehet

se është drejtuar me ankesa të ndryshme pranë Bashkisë Sarandë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a (UK Sarandë sh.a) por pa asnjë zgjidhje deri më sot.

Sikundër znj. N.T. shkruan, konkretisht lidhur me: *“...problematikën me rrjetin e shkarkimit të ujrave të zeza, i cili nuk është bërë në parametra nga ana e UK Sarandë si dhe për problematikën e mungesës së furnizimit me ujë të pijshëm, për shkak se të gjithë familjet kanë realizuar furnizimin me tubacione private dhe secili merr ujë në sasira të mëdha gjatë orarit, pasi kanë vendosur pompa të fuqishme apo tubacione të përmasave të mëdha, në mungesë të shtrirjes së tubacioneve për furnizim me ujë nga UK Sarandë.”*

Ankuesja shprehet se është drejtuar disa herë për zgjidhje pranë UK Sarandë sh.a dhe Bashkisë Sarandë, por pa sukses. Në këto kushte, ajo ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit

Pas regjistrimit të kësaj ankese, institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenet 13, 17 shkronja “a” dhe 18, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe nenit 19 shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, me shkresën K3/N14 – 2 prot., datë 05.08.2022, “Kërkesë për shpjegime” dhe me shkresën K3/N14 – 3 prot., datë 31.10.2022 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime” i jemi drejtuar Bashkisë Sarandë dhe UK Sarandë sh.a.

Në përgjigje tonës, me shkresën nr. 4777/1 prot., datë 09.11.2022, “Kërkesë për informacion për ankesën e qytetares N.T. ”, Bashkia Sarandë ju është drejtuar duke ju kërkuar që: *“...Me qëllim verifikimin dhe informimin e qytetarit për shqetësimet e paraqitura, kërkojmë nga ana juaj informacion me shkrim lidhur me parashtrimet e ankueses për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të zeza (informacioni të jetë i shoqëruar me dokumentacionin përkatës) si dhe veprimet që do të merren në vazhdim në kuadër të zgjidhjes së këtyre shqetësimeve.”*

Referuar përgjigje sa më sipër, u jemi ridrejtuar UK Sarandë sh.a për të na dhënë, përcjellë informacionin dhe dokumentacionin provues lidhur me masat e marra, me shkresat nr. K3/N14 – 6 prot., datë 16.07.2024, nr. K3/N14 – 7 prot., datë 25.10.2024 dhe nr. K3/N14 – 8 prot., datë 20.01.2025 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime dhe dokumentacion”.

UK Sarandë sh.a nuk ka kthyer asnjë përgjigje edhe pse nuk konstatojmë ekzistencën e ndonjë shkakut ligjor i cili do të mund të justifikonte vonesën, apo mosdhënien e saj. Avokati i Popullit gjen në shkelje flagrante përcaktimet kushtetuese, ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative dhe përcaktimeve të tjera ligjore, duke mos u zbatuar dhe cenuar rëndë parimin e respektimit të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Ky qëndrim i mbajtur nga UK Sarandë sh.a ka sjellë si pasojë zvarritjen e hetimit administrativ dhe pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme, si dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankueses.

Edhe pse tashmë Avokati i Popullit ka dërguar 5 (pesë) shkresa në organin tuaj publik, ku kërkohej shpjegime mbi trajtimin e problematikës së paraqitur në ankesën e znj. N.T., përsëri sot e kësaj dite nuk ka asnjë përgjigje dhe asnjë reagim zyrtar nga ana juaj duke krijuar kështu një situatë të pazakontë, e cila ka ndikuar në afatet e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana e institucionit tonë. Evidentohet lehtësisht neglizhenca apo mungesa e bashkëpunimit tuaj, thjesht duke parë afatin apo datën kur kemi kërkuar informacion, që i përket datës 05.08.2022, ndërkohë akoma nuk kemi një përgjigje prej organit tuaj (për më shumë se 2 vite e gjysëm).

Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion.

Në rrethanat e parashtruara sa më sipër ju bëjmë me dije se organi juaj publik e më konkretisht personat përgjegjës në UK Sarandë sh.a, gjenden në shkelje flagrante të Kodit të Procedurave Administrative, duke mos zbatuar dhe cenuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Mosdërgimi i shpjegimeve të kërkuara ka sjellë si pasojë, mostrajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë ndaj ankuesit.

Ky qëndrim i mbajtur nga personat përgjegjës, punonjës në UK Sarandë sh.a, ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme.

Ndërkohë kjo sjellje, cenon rëndë marrëdhëniet tona ndërinstitucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik. Neni 63 parashikon se: “Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohej prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. Organet dhe

funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.

Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime. Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentat ligjore që Kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë. Neni 63 pika 1,2 dhe 3 e tij parashikojnë instrumente të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet apo propozimi për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës.

Gjithashtu, edhe ligji nr.8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, parashikon të drejtën e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre. Madje ky ligj parashikon deri edhe propozimin apo rekomandimin drejtuar prokurorisë, për fillimin e procedimit penal, në rast të konstatimit të elementëve të veprës penale, si psh. shpërdorimit të detyrës nga nëpunësit e administratës publike. Neni 21, germa ç, i ligjit përcakton se Avokati i Popullit, mund të kryejë këto veprime: “ç) i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale; ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”. Ndërsa neni 22 i këtij ligji parashikon se: “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurave Administrative ashtu dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Neni 3 i këtij të fundit përcakton se: “Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin”.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në trajtimin e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e

Popullit, gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ është një detyrim kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik.

Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Nga ana tjetër, në kuadër të garantimit të transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik, qeveria shqiptare në miratim të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur 2020-2022 që bazohet në rekomandimet kombëtare dhe ndërkombëtare për mirëqeverisjen dhe reformën e administratës publike, përcjell nëntë objektiva strategjike të cilat fokusohen kryesisht në rritjen e aksesit në shërbimet publike dhe rritjen e përgjegjësisë përmes qasjeve të koordinuara për të përmirësuar cilësinë e informacionit për publikun, duke rritur integritetin, performancën dhe llogaridhënien e institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së përgjegjshme që lehtësojnë zbatimin e barabartë dhe të drejtë të ligjit dhe përmirësojnë shërbimin publik për të gjithë qytetarët . Gjithashtu, edhe në Planin e VI-të Kombëtar të Veprimit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur 2023-2025, programi i Qeverisë thekson përmirësimin e efikasitetit të administratës shtetërore dhe publike me qëllim plotësimin sa më efikas të nevojave të qytetarëve dhe ekonomisë si dhe masat që synojnë forcimin e transparencës, përgjegjësisë dhe integritetin.

Gjithashtu, duhet theksuar se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me *parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies*. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. **Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike.** Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Në rrethanat e parashtruara sa sipër, në rast se edhe pas këtij rekomandimi nuk mundësohet marrja e masave të nevojshme organizative për bashkëpunimin, bashkërendimin dhe bashkëveprimin e punës me Institucionin e Avokatit të Popullit, me qëllim kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave të dërguara nga Institucioni ynë, ju bëjmë me dije se nga ana jonë do të paraqiten materialet përkatëse në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Sarandë, në përputhje me nenin 248, të Kodit Penal për “Shpërdorim detyrë”, pasi vlerësojmë se UK Sarandë sh.a, është përgjegjëse për mosveprimin, apo për mungesën e dhënies së përgjigjeve përkatëse.

Referuar problematikës së hasur në këtë rast, me personat përgjegjës në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga UK Sarandë sh.a, titullari i këtij organi publik, të vlerësojë në përputhje ***me ligjin organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, veprimtarinë e personave përgjegjës mbi respektimin e afateve***

procedurale në shqyrtim të akteve si dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me legjislacionin aktual.

Për sa parashtruam, bazuar në nenin 22/1 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ku parashikohet se:

“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”,

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.
- Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës, të UK Sarandë sh.a, lidhur me mospërmbushjen e detyrimit ligjor, për t’i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.
- Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,* nisur nga problematika e ngutshme, kërkojmë të vlerësoni këtë rekomandim në mënyrë të menjëhershme, dhe pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

Erinda MELI

d.v